



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1539 Prot.

Tiranë, më 15.12 2017

**VENDIM QARKULLUES Nr. 261, datë 15.12.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi Raportin e sondazheve arkeologjike "Faza I", në kuadër të projektit "*Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit*"-subjekti "Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjellës Kanalizimeve" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e sondazheve arkeologjike "Faza I", në kuadër të projektit "*Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit*"-subjekti Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjellës Kanalizimeve" Durrës, realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Të vijojnë punimet e ndërtimit për projektin "*Projektim dhe Mbikëqyrje e ndërhyrjes në sistemin e kanalizimeve të ujrave të ndotura të Durrësit*", duke u kryer ndjekja në mënyrë periodike ditore e punimeve të gërmimit, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet subjektit "Drejtoria e Përgjithëshme e Ujësjellës Kanalizimeve"sh.a., shoqërisë së licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k. dhe ASHA.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTRE



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)